REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LUSHNJE
DREJTORIA E PERGJITHSHME E SHËRBIMEVE PUBLIKE,ZHVILLIMIT URBAN DHE RURAL
DREJTORIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE

Nr8985**prot** **Lushnje më,**22/09/**2026**

URDHËR
NR.260**Datë** 22/09/**2026**

MBI ORGANIZIMIN E PLANIT TË LËVIZJES SË AUTOMJETEVE TË TRANSPORTIT TË MALLRAVE NË QYTETIN E LUSHNJES

Me qëllim riorganizimin e lëvizjes së automjeteve në Qytetin e Lushnjes dhe në mbështetje të nenit 7 pika 2 , nenit 11 pika 3 shkronja "ç", nenit 4 4 shkronja "a", të ligjit nr. 8652, datë 31.07.2000 për "Organizimin dhe funksionimin e Qeverisjes Vendore" i ndryshuar; nenit 5 pika 3, nenit 7 pika 1 dhe 4, nenit 21 pika 2 dhe 3, nenit 37 pika 1 shkronja "b" të ligjit nr. 8378, datë 22.07.1998 "Kodi Rrugor i Republikës së Shgipërisë" i ndryshuar, nenit 8, nenit 121, 122, 124, 125 te ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999 "Kodi i Procedurave Adiministrative të Republikës së Shqipërisë i ndryshuar, Udhëzimit të MPPTT-së nr. 15 datë 24.07.2007 "Për kriteret dhe procedurat e lëshimit të licensave, autorizimeve dhe certifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor, i ndryshuar.

URDHËROJ

1. Ndalimin e qarkullimit të mjeteve ATP (automjet të transportit të përzier) me masë maksimale të autorizuar deri në 3.5 ton, si më poshtë;

-Hënë – Diel, ndalim qarkullimi ora 07;00 -12;00 dhe 18:00 -22;00

2. Ndalimin e qarkullimit të mjeteve të transportit me masë maksimale të autorizuar 3.5 - 6-5 ton, si më poshtë;

-Hënë – Diel, ndalim qarkullimi ora 07;00 -13;30 dhe 15:30 -22;00

3. Ndalimin e qarkullimit të mjeteve me tonazh të rëndë ATV (automjet të transportit të vecantë) me masë maksimale të autorizuar mbi 6-5 ton (Betoniere,kamionë ,trajler ,etj), si më poshtë; -

Adresa:Lagjia "Kongresi iLushnjes" Tel:+355 35 222139 E-mail:bashkia_lushnje@yahoo.com

Hënë – Diel, ndalim qarkullimi ora 06;00 – 00;00

4-Zonat e kufizimit të qarkullimit do të jetë përgjatë rrugës "Bulevardi i Kongresit" deri tek Rreth rrotullimi i Plasmasit , Rruga "Misto Mame ", Rruga "Fan Noli" deri tek Shëtitorja e Palmave ,Rruga "Pavarsia" ,Rruga "Uan Kondakciu", (tek Ypsiloni) ,Rruga "Besim Nuri" ,Rruga "Arben Vogli", Rruga "Azem Quka" ,sipas planvendosjes bashkëngjitur

5- Subjektet tregtare do të kryejnë veprimtarinë e tyre furnizuese sipas orarit përkatës dhe sinjalistikës së vendosur .

6. Lejohet qarkullimi i të gjithave mjeteve të shërbimit të urgjencave , zjarrfikësit , policisë mjetet e ndërmarjes së pasurisë publike, mjetet e transportit publik urban, mjetet e transportit turistik.

7- Qarkullimi i mjeteve gjatë kufizimit të vendosur nëpërmjet këtij urdhëri ,do të kryhet vetëm sipas autorizimeve përkatëse të lëshuara nga Bashkia Lushnje.

8- Ndërmarja e Pasurisë Publike duhet të vendosi sinjalistikën e përcaktuar në këtë urdhër brenda 5 ditëve.

9- Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Shërbimeve Publike, Drejtoria e Policisë Bashkiake , si dhe Ndërmarrja e Pasurisë Publike .

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR I BASHKISË
ERISELDA SEFA

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA LUSHNJE

Adresa:Lagjia "Kongresi iLushnjes" Tel:+355 35 222139 E-mail:bashkia_lushnje@yahoo.com

PLANI I VENDOSJES SE LEVIZJES SE AUTOMJETEVE TE TRANSPORTIT TE MALLERAVE NE QYTETIN E LUSHNJES



OBJEKTI	ZONAT E KUFIZIMIT TE QARKULLIMIT TE TRANSPORTIT TE MALLERAVE	NR.FLETES	A-01
VENDNDODHJA	Lushnje	FORMATI	420X297
		SHKALLA	
EMERT.I FLETES	PLANVENDOSJE		
DREJTOR	ING. ARIOLA BEQO		
PERGJEGJES	ARK. ALBAN MANOKU		
SPECIALIST	ARK. OKSANA BAXHO		
		REPUBLIKA E SHQIPERISE BASHKIA LUSHNJE	